



Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

PRILL 2023

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.


Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë




ankesa@amp.gov.al



0800 90 90

Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



denonco@amp.gov.al



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë


Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në
Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë
DVP-ve në Qarqe

Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



www.amp.gov.al



VEPRIME HETIMORE

Referimet e bëra në Prokurori

11 referime në Prokurori për **15** punonjës të Policisë së Shtetit dhe **4** shtetas, si të dyshuar për vepra të ndryshme penale.

Arrestuar/ndaluar në flagrancë

3 shtetas të arrestuar në flagrancë

Ekzekutimet e vendimeve të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

Vendosur caktimi i masës ndaluese "Pezullim i ushtrimit të një detyre nga shërbimi publik":

3 punonjës policie

Vendosur caktimi i masës ndaluese "Arrest në burg":

1 punonjës policie

Vendosur caktimi i masës së sigurimit personal "Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore":

2 shtetas

INSPEKTIVE/VENDIME

Gjatë muajit Prill janë kryer **6 inspektive**, prej të cilave;

- 4 të paplanifikuara, të iniciuara nga ankesat e qytetarëve, të cilat i janë nënshtruar hetimit administrativ dhe ankuesit i është kthyer përgjigje mbi përfundimet e inspektimit.
- 2 të planifikuara sipas Programit Vjetor të Inspektiveve të AMP-së, kryer në strukturat e Kufirit dhe Migracionit, Në përfundim janë paraqitur 12 rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor ndaj 49 punonjësve për "Shkelje të lehtë disiplinore".

Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar në total **10 praktika disiplinore** për të cilat ka konstatuar dhe vendosur fillimin e hetimit disiplinor për 23 punonjës policie, si më poshtë:

- Në 9 raste, për 22 punonjës policie ka nisur hetimin disiplinor për "Shkelje të rëndë"
- Në 1 rast, për 1 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka marrë vendimin për "Përfundimin e hetimit disiplinor dhe rekomandimin për shkelje të lehtë"

HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE

Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun



335 Telefonata

në linjën e gjelbër **08009090**, nga të cilat;

175 telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP (Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)

51 telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP (Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)

109 telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit (Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



Ankesa të trajtuara

97 ankesa

- Në **11** raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të drejta
- Në **61** raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të pabazuara
- Në **24** raste, ankesat e qytetarëve nuk provohen
- Në **1** rast, pas ankesës së qytetarit është krijuar dosje për ndjekje penale



Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo ankese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

93 ankesa